



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:046168
Datë: 15.09.2025
Numri i dokumentit: 07743767

K.Dh.Sh.II.nr.1106/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Fisnik Nuli, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit, Pionir DOO me seli në Beograd, Serbi, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Visar Gorani avokat nga Prishtina, kundër të paditures Liri LLC me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinot Berisha avokat nga Prizreni, për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.657/23 të datës 21.02.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28.08.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Pionir DOO me seli në Beograd, Serbi, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.657/23 i datës 21.02.2025, Vërtetohet

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur: I.Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Pionir DOO, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se pala e paditur Liri LLC, me nxjerrjen në treg të produktit :karamelë” i shënuar me ngjyrë të verdhë mjaltë, ari, kafe, e bardhë, e zezë, portokalli, e gjelbër, bezhë dhe e kuqe, me një ngjyrë dominuese e verdhë-ari okër që mbulon më shumë së 50% të sipërfaqes në pjesën qësnnore, pozicionuar në

qendër e shkruar me emrin e produktit, shkruar me markën “karamel lajthi” me ngjyrë kafe dhe të bardhë, poshtë markës ka imazhin e tri lajthive, një e prerë dhe një është lëvozhgë, një gjethe jeshile sipër dhe një imazh të një karamale lajthie të hapur dhe një të mbështjellë me foli, foli me ngjyrë të verdhë kafe me një lajthi në mes, e cila në thelb është e ngjashme me markën tregtare të padiëtsit “pionir” ka çënuar markën tregtare të paditësit të regjistruar pranë Agencionit për Pronësi Industriale ME nr.21256 “karamele”, si dhe të ndalohet i padituri të çënoj markën tregtare të paditësit si dhe të urdhërhjet i padituri që të heq nga qarkullimi të gjitha produktet siq është përshkruar dukja e tyre më lartë si dhe aktgjykimi të publikohet ë Radio Televizionin e Kosovës me shpenzimet e të paditurit, II. Detyrohet paditësi Pionir DOO, që të paditurit Liri LLC, t,ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,532.80€, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij Aktgjykimi, kanë paraqitur ankesë përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqse. I autorizuari i paditësit kundërshton aktgjykimin ankimor, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozimin që të aprovohet si e themeltë ankesa e paditësit, të anulohet aktgjykimi KE.nr.657/23 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, dhe lënda të kthehet në rivendosje.

I autorizuari i palës së paditur e kundërshton aktgjykimin KE.nr.657/23 i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, përkitazi vendimin për shpenzimet proceduale, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të ndryshohet dispozitivi II i aktgjykimit ankimor, ashtu që të obligohet paditësi t,ia kompensoj të paditurit të gjitha shpenzimet procedurale të specifikuara sipas këkresës.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi Pionir DOO me seli në Beograd, Serbi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 29.08.2023, ka ushtruar në gjykatë, padi kundër të paditurit Liri LLC me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së markës tregtare të paditësit, duke kërkuar që të aprovohet në tërsi si e bazuar kërkespacia e paditësit, dhe vërtetohet se i padituri Liri LLC, , me nxjerrjen në treg të produktit karamele” i shënuar me ngjyrë të verdhë mjaltë, ari, kafe, e bardhë, e zezë, portokalli, e gjelbër, bezhë dhe e juqe, me një ngjyrë dominuese e verdhë-ari okër që mbulon më shumë së 50% të sipërfaqes në pjesën qendrore, pozicionuar në qendër e shkruar me emrin e produktit, shkruar me markën “karamel lajthi” me ngjyrë kafe dhe të bardhë, poshtë markës ka imazhin e tri lajthive, një e prerë dhe një është lëvozhgë, një gjethe jeshile sipër dhe një imazh të një karamale lajthie të hapur dhe një të mbështjellë me foli, foli me ngjyrë të verdhë kafe me një lajthi në mes, e cila në thelb është e ngjashme me markën tregtare të paditësit “pionir” ka cënuar markën tregtare të paditësit të regjistruar pranë Agjenconit për Pronësi Industriale ME nr.21256 “karamele”, si dhe të ndalohet i padituri të cënoj markën tregtare të paditësit si dhe të urdhërhëtet i padituri që të heq nga qarkullimi të gjitha produktet siq është përshkruar dukja e tyre më lartë, si dhe aktgjykimi të publikohet në Radio Televizionin e Kosovës me shpenzimet e të paditurit.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar në padi dhe gjatë seancës gjyqësore deklaroi se është pronar i markës tregtare për produktin “karamel” e regjistruar në API me nr.21256 nga data 10.08.2017 me vlefshmëri deri më 31.12.2015. Paditësi ka të drejt ekskluzive që ta përdor shenjën të cilën e ka të regjistruar në API me qëllim të shënjimit të mallrave të subjektit afarist, për ti dalluar ato nga mallrat tjera të ngjashme si dhe pretendon se i padituri pa autorizim ka vënë në treg një produkt të shënuar me një shenjë e cila është identike më markën tregtare të paditësit, madje duke përdor të njëjtin emër “karamele”. Më tej deklaroi se marka tregtare e regjistruar nga i padituri është në shkelje të markës eksistuese dhe të mirnjohur të paditësit lidhur me mallrat apo produktet e njëjta me këtë rast i referohem markës figurative të kontestuar ngase marka verbale siq vërehet nga provat e lëndës ka skaduar me datë 19.06.2022 dhe nuk është vazhduar validiteti i saj. Me datë 08.01.2025 pranë API-së është dorëzuar kërkesë për deklarimin e shfuqizimit të markës tregtare, e cila kërkesë paraqet fakt të ri . Paditësi ka fituar statusin e markës së mirnjohur, pasi që produkti i mbrojtur nën markën 21256

në mes tjerash është në qarkullim në tregun lokal, regional dhe botëror për tashmë 60 vite. Gjykatës i propozon që të aprovoj në tërsi si të bazuar padinë e paditësit.

I padituri përmes të autorizuarit, në përgjigje në padi dhe në seancën gjyqësore ka kundërshtuar në tërsi si të pabazuar kërkespadin e paditësit, me arsyetimin se e njëjta nuk përmban faktet mbi të cilat bazohet kërkesa si dhe provat në bazë të cilave vërtetohen faket. Më tej thekson se i padituri ka të regjistruar markën tregtare “karamele” e prodhuar nga i padituri Liri LCC me datë 27.05.2029, se fjala karamele është emër gjenerik dhe përcakton llojin e mallit, respektivisht produktin karamele. Paditësi për momentin ka në treg produktin karamele me një dizajn dhe figurë e cila dallon nga marka e regjistruar, që vërtetohet nga provat e paraqitura me padi. I propozon gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar padinë e paditësit.

Dhoma e shkallës së parë në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 07.02.2025 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të paditësit e të paditurit, pas administrimit të provave, ka marr Aktgjykimin e atakuar me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkespadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata vleroi se kërkespadia e paditësit është e pabazuar, për faktin se produkti me të cilin paditësi pretendon se nga i padituri është shkelur marka tregtare, është i regjistruar pranë API-së dhe i njëjti gëzon mbrojtje juridike. Nga shkresat e lëndës rezulton se produkti i të paditurit “karamele” është i regjistruar pranë API-së si markë verbale përmes regjistrimit nr.14387 dates 29.04.2025 me afat të skadimit të mbrojtjes deri me 19.06.2022 dhe si markë figurative “karamele lajthi” ne klasën 30 dhe ngjyrat që mbrohen e verdhe, kafe, ta, bezhë, portokalli, e bardhë, e kuqe e gjelbër, përmes regjistrimit nr.24938 datës 27.05.2011 me afat të skadimit të mbrojtjes deri më 03.07.2028, po ashtu produkti “karamele” i paditurit rezulton i regjistruar pranë API-së si markë vebrale përmes regjistrimit nr.33915 datës 09.08.2024 dhe si markë figurative nr.33916 datës 09.08.2024 me validitet deri me 04.10.2033. Gjykata duke pasur paarsysh të drejtat e ekskluzivitetit të markës tregtare të garantuara me nenin 9 të Ligjit nr.08/L-075 për Markat Tregtare, si dhe bazuar ne provat e administruara, arrin në përfundimin se i padituri ka drejtën e plotë dhe të pakufizueshme të përdorimit të markës së tij, pasi që këtë të drejtë e ka fituar përmes regjistrimit të markës “karamele” pranë organit kompetent API. Andaj pretendimet e paditësit për shkelje të markës tregtare nga i padituri mbeten të pa qëndrueshme për shkak se edhe paditësi edhe i padituri janë bartës të pronësisë mbi markat e tyre tregtare të regjistruara pranë API.

Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, i vlerësoi të pabazuara në ligj, pretendimet ankimore të paditësit, i cili në ankes thekson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë kundërtë dhe të paarsyetuar ka konstatuar se ngjashmëria në mes markave tregtare nuk është objekt kontesti, se gjykata nuk ka shpjeguar pse nuk është kompetente për të gjykuar këtë çështje gjyqësore. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar drejt kur ka refuzuar kërkespadin e paditësit, me pretendimin se i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit me emrin e produktit “karamelle”, e regjistruar pranë API nr.21256, duke ndaluar të paditurit të cenoj markën tregtare të paditësit si dhe të urdhërohet i njëjti që të heq nga qarkullimi të gjitha produktet sipas përshkrimit të produktit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka zbatuar drejt edhe dispozitën e nenit 9 të Ligjit nr.08/L-075 për Markat Tregtare, që përcakton:

1.Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj.

Kolegji, vlerësoi se pretendimet e paditësit nuk gjejnë mbështetje ligjore për tu konstatuar shkelja e markës tregtare nga dispozita ligjore e lartcekur, meqë i padituri ka të regjistruar markën tregtare “karamelle” pranë API-se si markë verbale përmes regjistrimit nr.33915 datës 09.08.2024 dhe si markë figurative nr.33916 datës 09.08.2024 me vlefshmëri deri me datën 04.10.2023. Prandaj Kolegji nga provat e lëndës gjen se në rastin konkret edhe marka tregtare e paditurit është e mbrojtur me ligj, me produktin e ngjashëm të paditësit, dhe nuk mund të vërtetohet se padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit. Kolegji vlerësoi, se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore, se gjykata nuk ka shpjeguar pse nuk është kompetente për të gjykuar këtë çështje gjyqësore. Nga dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit ankimor, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë konstatim se nuk është kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridike. Mirpo me të drejtë në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetimin se nuk ka shqyrtuar ngjashmërinë midis markave të regjistruara të

palëve ndërgjyqëse, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me akte administrative ligjshmëria e të cilave nuk mund të vlersohet ne këtë procedurë.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë nuk i aprovoi pretendimet ankimore të palës së paditur në ankes lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës, pasi që gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt dispozitën e nenit 451.1 të LPK-së, kur i ka njohur paditësit shpenzimet e krijuara gjyqësore, ndërsa shpenzimet tjera të kërkuara jashte procesit gjyqësor nuk janë të bazuara.

Kolegji, vlersoi se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt faktet dhe në bazë të dispozitave ligjore, ka vërtetuar se paditësi nuk ka ofruar prova të bazuara se i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga sa u parashtrua e në mbështetje të dispozitës së nenit 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1106/25 datë 28.08.2025

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha